REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE

DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NE KATEGORINE EKZEKUTIVE

Lloji i diplomës niveli minimal i diplomës "Bachelor" Master Profesional ose te barazvlefshem

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", si dhe të Kreut II, IV dhe VI të VKM nr. 243, datë 18/03/2015 "Per pranimin, levizjen paralele, periudhen e proves dhe emerimin ne kategorine ekzekutive" i ndryshuar, **Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

1- (pozicion) - "Specialist Koordinim Donatore", ne Bashkine Maliq- **kategoria IV-3.**

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës se pranimit ne sherbimin civil per kategorine ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim ne sherbimit civil aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	**23.02.2025**
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL:	**28.02.2025**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- Identifikimi i prioriteteve sektoriale për investime dhe formave të tjera të asistencës teknike, bazuar në Planet Strategjike të Zhvillimit, apo Programeve për Zhvillimin Ekonomik Vendor të Bashkisë;
- Sigurimi i një procesi konsultimi intensiv me të gjitha strukturat e brendshme të Bashkisë dhe ato vendim-marrëse, për përcaktimin e listës së projekteve prioritare për financim nga donatorët.
- Koordinimi i procesit të përgatitjes dhe miratimit të programeve/projekteve për financim dhe ofrimin e këshillave për vendim-marrësit, mbi përmirësimin e cilësisë së tyre dhe rritjen e aftësisë përthithëse të fondeve;

- Organizimi i takimeve periodike me bashkitë e tjera në nivel qarku apo më gjerë, si dhe me grupet e interesit, për identifikimin e prioriteteve strategjike rajonale dhe hartimin e programeve e projekteve të përbashkëta për financim;
- Bashkërendimi dhe koordinimi me strukturat e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak, për përfshirjen e të gjitha projekteve të financuara nga donatorët në buxhetin vjetor si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), dhe parashikimin e detyrueshëm të kostos lokale (bashkëfinancimi nëse ka dhe TVSH).

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";
ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:
d) Te zoterojediplome te nivelit "Bachelor" Master Profesional ose te barazvlefshem ne Shkencat Shoqerore, Juridike .

Tjetër:

- Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve Publike të Bashkisë Maliq, dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 23.02.2025 BashkiaMaliq, Bulevardi "Rinia".

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **25.02.2025**, Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore të Bashkisë Maliq do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në stenden e Bashkisë Maliq**,** listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe daten ,vendin dhe oren e sakte ku do te zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerëzore të Bashkisë Maliq , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ndryshuar;
- Ligji mbi arkivat , i ndryshuar
- Ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin civil*" i ndryshuar;
- Kodin e Procedurave Administrative i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare*"; i ndryshuar,
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*" i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do te vleresohen per pervojen ,trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushen , si dhe çertifikimet pozitive .Totali i pikeve per kete vleresim eshte 40 pike.

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me :

a- Njohurite , aftesite , kompetencen ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes ;
b- Eksperiencen e tyre te meparshme ;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrierren.

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 60 pike.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "ëëë.dap.gov.al"

http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Menaxhimitte Burimeve Njerëzore të Bashkisë Maliq do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në stendat e Bashkisë Maliq.
Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e e fituesit.

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NE KATEGORINE EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se pozicionii renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimnëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë e ekzekutive.
Këtë Informacion do ta merrni në stenden e Bashkisë Maliq, duke filluar nga data 25.02.2025.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet qe duhet te plotesoje kandidati ne proceduren e pranimit ne sherbimin civil jane:

a - Të jetë shtetas shqiptar;
b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidati duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diploma te nivelit "Bachelor" dhe Master Profesional ne fushën e Shkencave Shoqerore, Juridike;

a) Tjeter:

- Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
a-Jetëshkrim i plotësuar
b-Fotokopje të diplomës (përfshirë diplomën bachelor diplomen master profesional si dhe listen e notave);
c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë nese ka);
d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet gjuhesore, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
g- Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Maliq .

***Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 28.02.2025 në* adresa Bashkia Maliq, Bulevardi “Rinia”.**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën ***10.03.2025*****,** Njesia e menaxhimit te Burimeve Njerëzore të Bashkisë Maliq do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit",dhe ne stenden e Bashkise Maliq listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit ne kategorine ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Maliq , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin civil*" i ndryshuar ;
- Kodin e Procedurave Administrative i ndryshuar ;
- Ligjin nr. 139/2015 "*Për Veteqeverisjes vendore*" i ndryshuar,
- Ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare*" i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*" i ndryshuar;
- Ligje specifike ne fushen perkatese.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
b- Intervisten e strukturuar me goje qe konstiton ne motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrieren , deri ne 25 pike.
c- Jeteshkrimin , qe konstiton ne vleresimin e arsimimit te pervojes e te trajnimeve , te lidhura me fushen, deri ne 15 pike.

Me shume detaje ne lidhje me vleresimin me pike, metodologjine e shperndarjes se pikeve menyren e llogarotjes, i gjeni ne Udhezimin nr. 2 date 27.03.2015 te Departamentit te Administrates Publike.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Maliq do të shpallë fituesinnë portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe stenden e Bashkise Maliq . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit ne portalin "Sherbimi Kombetar i Punesimit " si dhe ne stendat e Bashkise Maliq :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e "Sherbimit Kombetar te Punesimit " duke filluar nga data **10.03.2025.**